

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Gjuetarë satelitësh", "rrembyes robotësh" dhe "bllokime lazerësh"! Armët që SHBA ka vendosur në orbitë
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/16/gjuetare-satelitesh-rrembyes-robotesh-dhe-blokimet-lazere-sh-armet-qe-shba-ka-vendosur-ne-orbite/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:13:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 08:10:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a493d59d8edb083d0a2357b1fde5945a9cc8873a0b5b0cde459031de544b2cfa
TEKSTI	0a1ff247bbb812b51c41278d7102ed5f6dfd2aa5eee9aa4092952b5039cf9f10
PAMJA	01bb2473665365fea258c56da4a6717fc605f4d076f1bf80722d982704f9c085

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ebf999091be162f5efba5f43e9edd42b73eb56e0dc777e85d793f31bf954b85c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ebf999091be162f5efba5f43e9edd42b73eb56e0dc777e85d793f31bf954b85c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > BOTA

“Gjuetarë satelitësh”, “rrëmbyes robotësh” dhe “bllokime lazerësh”! Armët që SHBA ka vendosur në orbitë

10:10: 16/09/2026 në BOTA



Shtetet e Bashkuara kanë pranuar publikisht për herë të parë se kanë vendosur armë operacionale në orbitë, duke shënuar një zhvillim të ri në militarizimin e hapësirës.

Deklarata u bë nga Sekretari i Forcave Ajrore të SHBA-së, Troy Mainck, gjatë konferencës vjetore të Ajrit, Hapësirës dhe Kibernetikës në National Harbor, më 14 shtator. “Shtetet e Bashkuara tani kanë armë për kontrollin e hapësirës në orbitë, të afta për të mbrojtur forcat e armatosura kundër veprimeve armiqësore”, deklaroi ai.

Mainck nuk dha detaje mbi llojin e armëve, karakteristikat teknike, datat e lëshimit apo nëse sistemet janë testuar me zjarr të vërtetë. Sipas raportimeve të cituara në material, zyrtari amerikan argumentoi se publikimi i këtyre të dhënave nuk do t'i shërbente qëllimit të parandalimit.

Megjithatë, ekspertët kanë nisur të analizojnë se çfarë mund të fshihet pas deklaratës së Uashingtonit. Një nga skenarët kryesorë është përdorimi i sistemeve të luftës elektronike dhe bllokimit të frekuencave radio, të cilat mund të ndërpresin komunikimin e një sateliti me Tokën ose transmetimin e të dhënave.

Bllokuesit hapësinorë

Lexo edhe:

[FBI zbulon planin rus për vrasje në SHBA dhe Europë](#)

[Tre të vrarë nga të shtënat me armë në një dyqan në Stamboll](#)

Ekspterja e sigurisë hapësinore Victoria Samson ka deklaruar se beson se bëhet fjalë për një platformë të luftës elektronike dhe bllokimit hapësinor. Edhe astropolitologu Bledin Bowen ka vlerësuar se skenari më i mundshëm është një sistem jo-shkatërrues anti-satellitor.

TË GJITHA



“Gjuetarë satelitësh”, “rrëmbyes robotësh” dhe “bllokime lazerësh”! Armët që SHBA ka vendosur në orbitë

10:10: 16/09/2026



Kongresmeni amerikan: Anshmëria politike të mos ketë vend në Hagë

10:10: 16/09/2026



Zbulohet skema si FGP belge ‘fundosi’ klanin e Gerd “Gjeneralit”, kush është ‘Arbeni’ që ra në grackë!

10:03: 16/09/2026



FBI zbulon planin rus për vrasje në SHBA dhe Europë

09:58: 16/09/2026



Po transportonte 6 shtetas të huaj drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Devoll

09:40: 16/09/2026



Glauk Konjufca nga Haga: Lufta jonë kishte qëllim mbrojtës dhe stopim të gjenocidit

09:38: 16/09/2026



Rrëzohet helikopteri i lajmeve në Los Angeles, 3 të vdekur dhe 2 të plagosur

09:26: 16/09/2026

Keto pajisje mund të bllokojnë sinjalet e komandës nga loka drejt satelikut ose transmetimin e të dhënave nga sateliti drejt forcave në Tokë. Një sistem i vendosur në orbitë mund të ndërpresë edhe komunikimin ndërmjet satelitëve.

Një nga avantazhet e kësaj teknologjie është se efekti mund të jetë i ktheshëm: kur bllokuesi fiket, komunikimi mund të rikthehet pa qenë e nevojshme shkatërrimi fizik i satelitit.

Lazerë kundër satelitëve

Një tjetër kategori janë armët me energji të drejtuar. Sipas analizave të cituara në material, këto sisteme mund të përdorin lazerë për të verbuar përkohësisht sensorët optikë dhe infra të kuq të satelitëve.

Sistemet me fuqi më të madhe mund të shkaktojnë dëme të përhershme në sensorë ose në panelet diellore, duke e lënë satelitin pa energji. Dokumentet e deklasifikuara të DIA-s përmendin gjithashtu armë me mikrovalë me fuqi të lartë, të afta të dëmtojnë qarqet elektronike të një objekti.

Satelitët “gjuetarë” dhe krahët robotikë

Ekspertët nuk përjashtojnë as mundësinë e përdorimit të satelitëve të pajisur me sisteme kapëse. Një mjet hapësinor mund t'i afrohet një sateliti tjetër, ta kapë dhe ta zhvendosë në një orbitë tjetër.

Kjo teknologji mund të përdoret për qëllime civile, si pastrimi i mbetjeve hapësinore, por mund të shndërrohet edhe në një mjet kundër satelitëve ushtarakë. Sipas ekspertëve të cituar, Rusia dhe Kina kanë zhvilluar gjatë viteve të fundit operacione të afrimit dhe manovrimit pranë satelitëve të huaj.

SHBA-ja ndërkohë disponon programin GSSAP në orbitën gjeosinkrone, me satelitë që veprojnë pranë mjeteve të tjera hapësinore dhe mbledhin të dhëna mbi karakteristikat e tyre.

Në skajin më të ashpër të luftës hapësinore janë armët kinetike anti-satelitore, të cilat mund të shkatërrojnë fizikisht një satelit ose një raketë që arrin në hapësirë. Eksperti Bledin Bowen e konsideron këtë skenar më pak të mundshëm, por nuk e përjashton.

Një përplasje e tillë mund të ndodhë me shpejtësi orbitale që kalojnë 27 mijë kilometra në orë dhe nuk kërkon domosdoshmërisht përdorimin e eksplozivëve. Problemi kryesor është krijimi i sasive të mëdha të mbetjeve hapësinore, të cilat mund të shkaktojnë përplasje zinxhir dhe të rrezikojnë përdorimin e orbitave për periudha të gjata.

Etiketa: Arme orbitë SHBA

Lajme të lidhura



FBI zbulon planin rus për vrasje në SHBA dhe Europë

09:58 : 16/09/2026



Tre të vrarë nga të shtënat me armë në një dyqan në Stamboll

20:27 : 15/09/2026



Lufta me Iranin i kushtoi SHBA-së 33.4 miliardë dollarë

17:39 : 15/09/2026



Zgjedhjet dhe vonesat institucionale në Kosovë "pengojnë agjendën" me SHBA-në

12:58 : 15/09/2026



Trump kundër ngadalësimit të ritmit të AI: Ide kineze, SHBA duhet të ruajë epërsinë

11:45 : 15/09/2026



Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane: Evropa rrezikon të mbetet peng i SHBA-së dhe Kinës për AI

09:28 : 15/09/2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.